



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
**Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova**

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese me datën 28.10.2024, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal**

- I. **Znj.Dula Karisik**, emërohet anëtare e kuvendit komunal në Istog, nga subjekti politik "Gradjanska Inicijativa Bosnjaka Istok-GIBI", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z.Melis Smakic.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Dula Karisik dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

**Arsyetim**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 24.10.2024, Nr.07/7/1842/2024, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal z.Melis Smakic, i cila ka dhënë dorëheqje, për arsye të punësimit në shërbimin policor të Kosovës.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është znj.Dula Karisik.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 28.10.2024

